



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

653-26-4125-2-2-1/C812

KOMUNA E KAMENICËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

"NEWS" SH.P.K., L. e Prizrenit, 143, ISTOG, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:



Hartimi i Projekteve-Ritenderim me numër identifikues: 653-26-4125-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Kontraata janë të planifikuara për 2 lote si vlerë e parashikuar nga 50,000.00Euro . Kontrata do të lidhen sipas pershkrimit të çmimeve dhe pozicioneve njësi që janë të parapara tek pershkrimi i çmimeve

Nr.	Grupi
2	LOT 2- Hartimi i projekteve për infrastrukture Rrugore

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 17.07.2026 dhe përfundon në datën 16.07.2027

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Sipas nevojhave të njësisë kekruese

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është 50,000.00 Euro sipas vlerës se parashikuar . Tejkalimi i vlerës se parashikuar nuk është i lejuar pasi që kontrata është me çmime njësi dhe nuk ka sasi të sakta .

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Urim Thaqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	17.07.2026
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Rinor Klaiqi
Pozita:	I Autorizuar
Nënshkrimi:	
Data:	17.07.2026
Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriterët e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktën pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballlohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të menjnuar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhrat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet të kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetëm në emër të vetë Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- të njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rrezikët, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, dëmet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asetit të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <i>Vendim i ZKA-se</i>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 5,000.00Euro me kohëzgjatje prej 13 muaj kalendarike
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë [shëno shumën] b) Përgjegjësia e palës së tretë [shëno shumën] c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve [shëno shumën] d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumën] e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve [shëno shumën]
Pagesat		Pagesat do të behen në fazën sipas projekteve të dorëzuara dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Projektet duhet të dorëzohen sipas dokumenteve shtese tek dosja e tenderit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve do të bëhet në mes të AK dhe Operëtorit ekonomik
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Komerciale në Prishtinë pajtim me ligjin në Kosovë. Ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA -II- PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE - Hartimi i Projekteve LOT 2

SPECIFIKIMI I PROJEKTEVE PËR TË CILËT DUHET HARTUAR DOKUMENTACIONET TEKNIKE TË OBJEKTIVE E INFRASTRUKTURËS (NDËRTIMI I ULËT)

Nr. i objektit	Emri i objektit ndërtues	Lloji i objektit ndërtues	Tipi i objektit	Përcjellësi	
				Totali me tash	Totali me tash
1	të infrastrukturës (Ndërtimtari e ulët)	Projektimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale (me të gjitha fazat përcjellëse)	objekt i ri Rendvrim / Rekonstruim	m' m' m'	0.02 0.02 0.02
2		Projektimi i lëshesave pllakore me hapësirë drejtë prej /2-10/ m' dhe gjerësi 4-10 m' (me të gjitha fazat përcjellëse)	objekt i ri Rendvrim / Rekonstruim	m' m' m'	0.02 0.02 0.02
3		Projektimi i ruotureve në pjesët urbane dhe rurale (me të gjitha elementet përcjellëse)	objekt i ri	m'	0.03
4		Projektimi i mureve mbrojtëse me lartësi deri në 2m' (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m'	0.01
5		Projektimi i rregullimit të shtatit të lumit (me të gjitha fazat përcjellëse)	objekt i ri Rendvrim / Rekonstruim	m' m' m'	0.05 0.05 0.05
6	PJESA 1	Projektimi i rrjetit të kanalizimit /fekal/ në pjesën urbane dhe rurale (me të gjitha fazat përcjellëse)	objekt i ri	m'	0.05
7		Projektimi i rrjetit të kanalizimit /atmosferik/ të hapur dhe të mbyllur, në pjesën urbane dhe rurale (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m'	0.03

[Signature]

Objekte

Objekte									
8	Projektimi i rrjetit të ujësjellës në pjesën urbane dhe rurale duke përfshirë humbimin sipërfaqësor dhe nëntokësor për ujë të pijshëm (me të gjitha fazat përcjellëse), projektimi i kanaleve të hapura për ujë, projektimi i sistemeve të ujitjes automatike, fontanave (qeshmever) etj.	objekt i ri	m ³	0.02	1.02				
		Renovim./ Rikonstruim	m ³	0.01	0.29				
9	Projektimi i infrastrukturës së ndërgjimit publik (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m ³	0.01	0.59				
Pjesa e shumta e të ndërtuarave (të cilët janë të ndërtuar)					€ 0.32 € 7.37				
10	Projektimi i urave me hapësirë dridhe prej 10-50 m ³ dhe gjatësi 4-10 m (me të gjitha fazat përcjellëse)	objekt i ri	m ²	0.01	0.10				
		Renovim./ Rikonstruim	m ³	0.02	0.15				
11	Projektimi i gropave septike dhe impianteve të kanalizimit fokal (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m ³	0.01	0.01				
12	Projektimi i mureve mbrojtëse me lartësi mbi 2m (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m ³	0.02	0.40				
13	Vizualizimi i projekteve infrastrukturale me 3D në QGIS ose ndonjë softuer të ngjashëm open source	Copë	m ²	0.01	0.02				
13	Projektimi i infrastrukturës - regullimi i nyjeve të komunikacionit (me të gjitha objektet përcjellëse)	objekt i ri	m ²	0.01	0.03				

MBI
10/10/2023

10/10/2023

14	Hartimi i të gjitha fazave, elaboretave të projekteve të ndryshme për kompletimin e projekteve kryesore me faze specifike kur është projekti ideor i punuar nga AK.	m ²	0.01	0.01
15	Shqyrtimi i konstruksionit nga aspekti profesional i stabilitetit dhe funksionalitetit.	m ²	0.01	0.10
16	Përgatitja, për prezantime, i 3D modeleve (maketa), të përgatiten me 3D printer.	cope	0.01	0.10
		€	0.11	€ 0.92

PIESA 2 Shuma e të dy ofertave (nëse ofrohet kryesor për njësi)

Në rastet kur autoriteti kontraktues pas hartimit të projektit ideor për të njëjtin projekt kërkon edhe hartimin e projektit kryesor vlera për pagëzë do të llogaritet vetëm e hartimit të projektit kryesor:

R E K A P I T U L I M I				
PIESA 1	Shuma e të dy ofertave (nëse ofrohet kryesor) për njësi	Çmimi	Freja	Çmimi i duhur
PIESA 2	Shuma e të dy ofertave (nëse ofrohet kryesor) për njësi	€ 7.69	0.7	€ 5.38
		€ 1.03	0.3	€ 0.31
TOTALI I PESHUAR		€		€ 5.69

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIKOJE

Emri i kompanisë: **NEWS SHPK**


Adresa e plotë: **Rr. L. Prizrenit, nr. 143, Istog**

Përfqësuar nga: **Fisnik Lashi**

Emri dhe mbiemri: **Drejtori**

Pozita: **2.04.2026**

Data: **2.04.2026**

Nenshkrimi: 

Vula: 

LOT-2

Përshkrimi

Në bazë të planifikimit, në përputhje me Ligjin e ndërtimit, në funksion të zvoglimit të shpenzimeve dhe ofrimit të shërbimeve më cilësore teknike, Komuna e Kamenicës përmes Zyrës së Prokurimit, parashih që të angazhoj ndërmarrje – operator ekonomik për ofrimin e shërbimeve profesionale të projekteve në afatë të gjatë kohor (12 muaj).

Operatori Ekonomik, apo kompania projektuese e cila duhet të angazhohet për të punuar projektet për nevoja të Komunës së Kamenicës, duhet të ketë në stafin e vet, apo të ketë kontrata të noterizuara me këtë staf të inzhinierëve përkatës:

- 1 Inzhinier të diplomuar të arkitekturës (apo master)
- 1 Inzhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv (apo master)
- 1 Inzhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi i hidros (apo master)
- 1 Inzhinier të diplomuar të elektros (apo master)
- 1 Inzhinier të diplomuar të makinerisë (apo master)
- 1 Gjeodet i licensuar.

Shërbimet profesionale të cilat kërkohen nga operatori ekonomik janë:

DETYRA PROJEKTUESE HARTIMI I PROJEKTEVE PËR OBJEKTE TË INFRASTRUKTURËS (Rrugore, Trotuare, Ndriçim Publik, Mure mbrojtëse, Ujësjiellësa, Kanalizime, etj.)

-Kërkohet ofrimi i shërbimit në projektim të rrugëve të reja, renovimin dhe sanimin e rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse, projekteve Rrugore, Trotuare, Ndriçim Publik, Mure mbrojtëse, Ujësjiellësa, Kanalizime, Shtigje, etj).

Standardet e projektit dhe kriteret

-Hartuesi për rikonstruimin, sanimin dhe ndërtimin e rrugëve me tërë infrastrukturën përcjellëse, duhet të bëjë përgatitjen e projektit komplet sipas sipas ligjit të ndërtimit dhe akteve nenligjore në fuqi.

Projekti duhet të dorëzohet në **5 kopje** lidhje të fortë dhe në formë elektronike **PDF dhe DWG**

-Vëllimi i punëve do të jetë në varësi nga kërkesat e komunës për hartimin e projekteve.

-Rikonstruimi dhe ndërtimi i ri kërkojnë komplet të gjitha fazat e projektit.

-Të gjitha projektet duhet të kenë si kërkesë të cekur në fillim të paramasave pjesën tekstuale si në vijim **“Sasitë e prezantuesja janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t’ia prezantoj Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim, përmes Librit Ndërtimorë, vlerat reale të sasive të gjetura në punishte”**.

-Të gjitha projektet duhet të kenë si kërkesë të cekur në fund të listës së pozicioneve të paramasave, pjesën tekstuale si në vijim; **“Pas ekzekutimit të punimeve, nëse gjatë ndërtimit projekti pëson ndryshime, ekzekutuesi i punëve duhet të dorëzoj tek Autoriteti Kontraktues matjet gjeodezike dhe projektin e ekzekutuar në teren”** sipas kushteve të cekura më lartë.

Përshkrimi i përgjithshëm për pozicionet përkatëse

Projektet ideore për objekte të infrastrukturës (ndërtimi i ulët):

Duhet të përmbajnë:

Të dhënat e kompanisë projektuese

Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve tjerë të nënshkruara dhe vulosura.

Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.

Situacionin gjeodezik (pjesën grafike dhe koordinatat e matura) (1:500 ~ 1: 1000)

Projektin Konceptual (nëse kërkohet)

Përshkrimin teknik të punimeve,

Paramasën dhe paralogarinë

Situacionin, (1:500 ~ 1: 1000)

Bazat (1:100)

Prerjet gjatësore dhe tërthore (1:100)

Fasadat (1:100)

Perspektivat, Imazhet, Vizualizimet

-Drafti i projektit paraprakisht duhet të dorëzohet tek A.K, për vlerësimi, vërejtje dhe sygjerime eventuale.

-Pas aprovimit nga A.K.-ja, projektet (dokumentacionet tekniko investive) duhet të punohen të formatizuara në format "A4", në pesë kopje të forta dhe pesë kopje elektronike -5 CD(DVD) në formatin " PDF dhe DWG".

2.PROJEKTET KRYESORE OBJEKTE TË INFRASTRUKTURËS (NDËRTIMI I ULËT):

2.1. Inçizimi gjeodezik

Në kuadër të inçizimit gjeodezik në situacion të veçantë të paraqitet rruga ekzistuese, ku paraqitet skaji i rrugës, gjerësia e trotuarit në të dy anët e rrugës, dhe vija e ndërtimit të objekteve përgjatë rrugës.

Gjerësia e inçizimit të jetë 2x25m' (nga 25m' në dy anët e rrugës llogaritur nga aksi). Gjithashtu në kuadër të matjeve gjeodezike përfshihen edhe kufijtë e parcelave në të cilin prek objekti dhe kufijtë e parcelave fqinje me objektin që projektohet. (1:500 ~ 1: 1000)

-Aty ku Aplikohen sipas Ligjit të Ndërtimit dhe akteve nenligjore të tij, A.K. mund të kërkojë edhe elaboratet si vijim:

-Elaborati i Gjeomekanikës.

-Elaborati i Organizimit të vendpunishtes.

-Duke u bazuar në ligjin e ndërtimit AK. mund të kërkojë edhe Elabore të tjera.

2.2 Projekti i kanalizimit dhe ujësjellësit

Projekti i kanalizimit të ujërave të zeza ose kolektorët

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve të nënshkruara dhe vulosura.
- Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Të dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike dhe hidrologjike.

- të bëhet inçizimi i gjendjes ekzistuese përgjatë shtrirjes së kanalizimit të gypave, pikat mbledhëse – shpërndarëse, pusetat, instalimet etj. (1:500 ~ 1: 1000)

Hartimit të projektit i paraprijnë llogaritjet teknike-hidraulike dhe kërkesat përgjatë këtij aksi të kanalizimit si dhe të studiohet definimi i lidhjeve me rrjetin ekzistues të kanalizimit. Të gjitha të dhënat në lidhje me instalimet e gypave të kanalizimit nga hartuesi i projektit të kërkojnë nga organet kompetente KRU "Hidromorave".

-Projekti kryesor i kanalizimit të ujërave të zeza duhet të përmbajë; përshkrimin teknik, llogaritjet teknike-hidraulike, paramasën parallogarinë me qmime dhe pa qmime, situacionet 1:500-1:1000, prerjet gjatësore 1:100/1000, detajet 1:10-1:25-1:50, etj.

Projekti i kanalizimit atmosferik/kolektorët apo kanaleve atmosferike

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve tjerë të nënshkruara dhe vulosura.
- Deklaratat e nënshkruar e pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Të dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike dhe hidrologjike.

- të bëhet inçizimi i gjendjes ekzistuese dhe në harmoni me studimet llogaritjet teknike-hidraulike që duhet bërë në lidhje me ujërat atmosferike, të hartohet projekti për trajtimin e tyre dhe të parashihen lidhjet e tyre me rrjetin ekzistues përgjatë kyejeve të rrugëve etj.

-Projekti kryesor i kanalizimit atmosferik duhet të përmbajë; përshkrimin teknik, llogaritjet teknike-hidraulike, paramasën parallogarinë me qmime dhe pa qmime, situacionet 1:500-1:1000, prerjet gjatësore 1:100/1000, detajet 1:10-1:25-1:50, etj.

Projekti i ujësjellësit (duhet të përmbajë):

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve tjerë të nënshkruara dhe vulosura.
- Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Të dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike dhe hidrologjike.
- Planin dinamik të rrjedhës së punëve.

- të bëhet inçizimi i gjendjes ekzistuese të instalimeve të gypave të ujit, nyjet, pusetat etj. Hartimit të projektit duhet t'i paraprijnë llogaritjet teknike-hidraulike dhe të studiohet definimi i lidhjeve me rrjetin ekzistues të

ujësjellësit. Të gjitha të dhënat në lidhje me instalimet e ujit, hartuesi i projektit duhet t'i kërkojë nga organet kompetente KRU "Hidromorava".

-Projekti kryesor i ujësjellësit, përshkrimi teknik, llogaritjet teknike-hidraulike, paramasën parallogarinë me qmime dhe pa qmime, situacionet 1:500-1:1000, prerjet gjatësore 1:100/1000, detajet 1:10-1:25-1:50, etj.

2.3 Projektin e ndriçimit publik (duhet të përmbajë):

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve të nënshkruara dhe vulosura.
- Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Të dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike. (1:500 ~ 1: 1000)

-të bëhet inçizimi i gjendjes së rrjetit elektrik ekzistues të instalimeve elektrike të rrymave të forta dhe të dobëta dhe në harmoni me studimet llogaritjet teknike-fotometrike të bëra, të bëhet përvetësimi i trupave ndriqes dhe të gjitha elementeve tjera përbërëse të sistemit të ndriçimit publik për pjesën që kërkohet. Të gjitha shënimet në lidhje me këto instalime nga hartuesi i projektit duhet të sigurohen në kompanitë përkatëse KEK-u, PTK etj.

-Projektin kryesor i ndriçimit publik duhet të përfshijë, përshkrimi teknik, llogaritjet teknike-fotometrike, paramasën parallogarinë me qmime dhe pa qmime situacionet 1:500-1:1000, prerjet 1:100/1000, detajet 1:10-1:25-1:50, paraqitje 3 dimensionale të ndriçimit, etj, projekti duhet të bëhet në bazë të rregullave të IEC-DIN 5044, trupat ndriqes duhet të jenë LED.

2.5 PROJEKTET E RRUGËVE (duhet të përmbajë):

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve të nënshkruara dhe vulosura.
- Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Të dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike, gjeologjike, gjeomekanike dhe hidrologjike (1:500 ~ 1: 1000)
- Përshkrimi i hollësishëm teknik
- Llogaritjen e të gjitha elementeve të objekteve infrastrukturore
- Llogaritjet teknike për të gjitha fazat
- Paramasa dhe parallogaria
- Planin dinamik të rrjedhës së punëve.
- Koordinatat e pikave kryesore dhe pikave detale,
- Koordinatat dhe knutat e bazës gjeodeze në brezin rrugor,
- Përshkrimi i komunikacionit,
- Përshkrimi dhe studimi për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ndikimi i rrugës në mjedis.

o PJESA GRAFIKE

- Inçizimi gjeodezik (duke përfshirë të gjitha objektet dhe elementet tjera në brezin 2x25 m nga mesi i rrugës) të paraqitur me izohipsa (1:500, 1:1000)
- Profilët normale me detalet standarde në shkallë 1:50, 1:100 në distancë 25 m nga njera tjetra,
- Plani i situacionit për të gjitha fazat e planifikimit në shkallë 1: 500,
- Profilët tërthore dhe karakteristike në shkallë 1:50
- Plani i nivelimit të udhëkryqeve dhe brezit rrugor
- Profili i masave
- Detalet standarde dhe jo standarde konstruktive
- Projekti kryesor i udhëkryqeve me planin e situacionit në shkallë 1:100
- Profili gjatësor në shkallë 1:500/50
- Paraqitja detale grafike e largimit të ujërave atmosferike dhe nëntokësore
- Zgjidhjet gjeometrike dhe niveluese të udhëkryqeve në përpjesë 1:100
- Detalet zbatuese P=1:50;1:25;1:20;1:10 sipas nevojës.
- Projekti i konstruksionit të rrugës
- Projekti i objekteve inxhinjerieke (muret mbrojtëse, objektet për largimin e ujërave dhe urat).

2.6 Projekti i urave (duhet të përmbajë):

- Të dhënat e kompanisë projektuese
- Vendimet, kontratat e emërimit të projektuesve të nënshkruara dhe vulosura.

- Deklaratat e nënshkruara dhe vulosura të pjesëmarrësve në projekt se projekti është punuar në bazë të ligjeve dhe akteve nenligjore në fuqi.
- Te dhënat e përgjithshme për projektin
- Lënda e projektit
- Paraqitja e shënimeve gjeodezike. (1:500 ~ 1: 1000)
 - Elabaratën hidrologjik (nivele e prurjeve ujore)
 - Elabaratën gjeomekanik (aftësia mbajtëse e tokës ku ndërtohet)
 - Planin dinamik të rrjedhës së punëve.
 - Përshkrimin teknik, llogarinë statike, paramasën dhe parallogarinë, bazat dhe prerjet në përpjesë 1:50; detalet 1:10, detalet e kallupimit dhe detalet e armimit.
 - Projekti i të dhënave gjeodezike
 - Projekti i mbrojtjes së ambientit
 - Projekti i organizimit optimal për ndërtimin e rrugës së perkoheshme. (nese aplikohet)
 - Projekti i instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit fekale dhe atmosferik (nese aplikohet)
 - Projekti i gropës septike
 - Kushtet teknike për ekzekutimin e punimeve
 - Projekti për zhvillimin e komunikacionit gjatë kryerjes së punimeve.

Tabela e pjesëve grafike duhet të ketë logon e Komunës si investues dhe hapësirën e aprovimit nga menaxherët e projektit të investuesit, ndërsa nga ana e projektuesit përmbanë logon e projektuesit, menaxherin e projektit dhe pjesëmarrësit në projekt. Hartuesi i projektit gjatë projektimit duhet të konsultohet me organin mbikëqyrës (menaxherin e kontratës-projektit) dhe të merren për bazë udhëzimet që i jep.

3. Forma e dorëzimit të projektit

- Faza e parë - Projekti ideor i cili duhet të merr pëlqimin nga A.K,
- Faza e dytë - Projektet kryesore komplet, së bashku me elabaratet e nevojshme për secilin projekt, duhet të marrin pëlqimin nga A.K.

Projekti kryesor me të gjitha elementet e kërkuara sipas dokumentacionit tenderues duhet të punohet në 5 (pesë) kopje, lidhje të fortë A4 dhe 5 CD. Forma elektronike duhet të jetë në versionin " PDF dhe DWG file ", në gjuhën shqipe.

-Çdo projekt duhet të ketë të nënshkruar listen e projektuesve dhe gjeodetit, si dhe çdo fletë e projektit të jetë e nënshkruar nga projektuesit pjesëmarrës në projekt, gjithashtu edhe të pjesa e situacionit gjeodezik duhet të nënshkruhet gjeodeti përgjegjës.

Në momentin e dorëzimit të projektit nga OE dhe aprovimit të tij nga AK, të gjitha të drejtat mbi projektin barten të porositesë së projektit- **Komuna e Kamenicës**.

VËREJTJE:

-Matjet gjeodezike aplikohen në të gjitha llojet e projekteve që porositen nga AK. e që punohen nga kompania hartuese e projektit.

-Operatori Ekonomik pas hartimit të projektit duhet të hartoj edhe planin dinamik të realizimit të punëve për të gjitha fazat e ndërtimit dhe t'ia bashkangjës projektit.

-Secila faqe e projektit duhet të jetë e nënshkruar nga projektuesi i fazës përkatëse.

-Drafti i projektit të kërkuar, paraprakisht duhet të dorëzohet si kopje fizike tek A.K, për vlerësim, vërejtje dhe sygjerime eventuale.

-Pas përmirësimit të vërejtjeve eventuale, OE prap dorëzon për aprovim dokumentacionin tekniko-investiv (projektin) tek A.K, ndërsa aprovimi për pagesë bëhet nga Menagjeri i Kontratës-Projektit.

-Në rast se gjatë implementimit të projektit investiv A.K. gjene vërejtje në projekt, hartuesi i projektit obligohet t'i bëjë përmirësimet e projektit në afat mbrenda 5 ditësh.

-Në rast se nevojës së ndryshimit apo plotsimit të projektit gjatë ekzekutimit të projekteve në teren, në bazë të kërkesës së menagjerit dhe mbikëqyrësit, hartuesi i projekti është i obliguar që të iu përgjigjet në aspektin profesional.